


01-1442



Në bazë të nenit 21, 44, 79 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L -031, dt.21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, dhe nenit 15 pika "d" të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01nr.110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ 06/2017 dt. 23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02 – 143279/20 dt.17.08.2020, të kërkuësve / pronarëve Jeton Govori, Valon Çoçaj, "Imobiliare Friuli"sh.p.k. nga Prishtina, për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 154396/19 dt.20.09.2019, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 01.09.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

VAZHDIMI I AFATIT TË VLEFËSHMËRISË VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE,
05NR.350/02 – 154396/19 DT.20.09.2019

I. I Vazhdohet afati i vlefshmërisë, Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 154396/19 dt.20.09.2019, kërkuësve / pronarëve, Jeton Govori, Valon Çoçaj, "Imobiliare Friuli"sh.p.k. nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C", "D", "E", "F", "G" & "H" në kuadër të Bllokut urban "A-13", Tipologjia e ndërtimit "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale, nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matëçan, sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - "zgjidhjes urbane"

II. Afati i vlefshmërisë së vendimit të kushteve ndërtimore nga paragrafi I. i këtij vendimi, është një(1) vit, dhe do të prodhoj efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me aktin administrativ.

A r s y e t i m

Kërkuësit / pronarët, Jeton Govori, Valon Çoçaj dhe "Imobiliare Friuli"sh.p.k. nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02 – 143279/20 dt.17.08.2020, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të vendimi të kushteve ndërtimore të përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Me kërkesë, kërkuësit kanë prezantuar: Fotokopjen e pa vërtetuar të Vendim të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 154396/19 dt.20.09.2019, dhe fotokopjen e manualit gjeodezik të parcelave kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matëçan.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës dokumentacionit të bashkangjitur, konsultimin e dosjes së lëndës 05nr.350 – 111747 dt.10.05.2016, rregullativën ligjore në fuqi nga aspekti i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se:

Bazuar në dosjen e lëndës, 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, kërkesë kjo për caktimin e kushteve ndërtimore, konstatohet se vendimi i kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 154396/19 dt.20.09.2019, ka filluar prodhimin e pasojës juridike nga data e njoftimit të kërkuësit me aktin administrativ, kurse kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 17.08.2020, e që është në harmoni-brenda afatit dhe pikës 8 të nenit 13 të UA 06/2017 të MMPH.

Bazuar në paragrafin XV. të Kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 154396/19 dt.20.09.2019, dhe pikën 8 të nenit 13 të UA 06/2017 të MMPH-së, ku thuhet se citojmë "*Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshtja është pranim do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja*

ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor ", andaj konstatohet, se kërkuessit kanë plotësuar kushtin për vazhdimin e vendimit të kushteve ndërtimore.

Andaj, bazuar në konstatimin e lart shënuara dhe rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë është i bazuar dhe ligjor, dhe kjo drejtori të njëjtën vendosi ta vazhdoj edhe për një(1) vit tjetër, përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimi të kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA, Departamenti Ligjor i Ambientit.

I dërgohet: Kërkuessve, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 154396/19 dt.02.07.2019.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR. 350/02 – 154396/19 DT.01.09.2020**

Zyrtari,
Ergyn Hajredini,



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi,



DREJTORI
Ardian Olluri

